



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 08.11.2019

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIM I RRJETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT “TELEKOM ALBANIA”, NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 4 STACIONE BAZË TË EMËRTUARA: “KEPI I RODONIT 1563”, “DHËRMI BEACH”, “SELVIA NEW 0118” DHE “CHATEAU LINZA 0214”, ME VENDNDODHJE NË BASHKITË DURRËS, HIMARË DHE TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Telekom Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit “Telekom Albania”, nëpërmjet shtimit të antenave për 4 stacione bazë të emërtuara: “Kepi i Rodonit 1563”, “Dhërmi Beach”, “Selvia New 0118” dhe “Chateau Linza 0214”, me vendndodhje në Bashkitë Durrës, Himarë dhe Tiranë”, me zhvillues shoqërinë “Telekom Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet i Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 4 stacioneve bazë, vetëm pas:
  - a. Për stacionin “**Kepi i Rodonit 1563**”:
    - Urdhri i Ministrit për heqjen nga fondi pyjor/kullosor për sipërfaqën në të cilën do të vendoset struktura e antenës;
    - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
  - b. Për stacionin “**Dhërmi Beach**”:
    - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.



c. Për stacionin “**Selvia New 0118**”:

pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

d. Për stacionin “**Chateau Linza 0214**”:

- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

